



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1334/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtaret Muhamet Rexha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Ridvan Abdyli, në cilësinë e Kandidatit për Anëtarë të Kuvendit Komunal, në Gjilan nga radhët subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), paraqitur kundër Kryesuesit të Vendvotimit (KVV) QV0406D/01R në Dobërçan, për shkak të mos lejimit të shënimit të vërejtjes në librin e votimit, në seancën e panelit të mbajtur me 27.12.2013, mori këtë:

V E N D I M

HIDHET si e parregullt ankesa e Ridvan Abdyli, në cilësinë e Kandidatit për Anëtarë të Kuvendit Komunal në Gjilan nga radhët subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK).

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 24.12.2013, nga Ridvan Abdyli, në cilësinë e Kandidatit për Anëtarë të Kuvendit Komunal, në Gjilan nga radhët subjektit politik PDK, me të cilën pretendon se kryesuesi i dhomës Nr.1 nuk i ka lejuar të bëjnë ankesë në librin e votimit.

PZAP-i, shqyrtoi rregullsinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e parregullt

Nga shkresat e lëndës PZAP-i konstatoi se ankesa është e parregullt sepse nuk i plotëson kushtet e parapara në nenin 3.6 pika d të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më të cilën dispozitë kërkohet vërtetimi nga pala ankuese lidhur me vërtetësinë e përmbajtjes së ankesës.

Parregullsitë e ankesës qëndrojnë në atë se parashtruesi i ankesës nuk e ka nënshkruar fare ankesën, që është në kundërshtim me dispozitën e lart theksuar.

Prandaj bazuar në nenin 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it si dhe në nenin 118.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr.1334/2013 më datën 27.12.2013

Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha

Këshillë juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.